

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

DHOMA CIVILE

**Nr.Regj.Them. 192
1996/2**

Data E Regjistrimit 13.01.2021

Nr. Vendimit

Data 17.06.2021

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

(Për depozitim vendimi OJF)

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRE NGA:

Anila KARANXHA – GJYQTARE

Sot më datë 17.06.2021, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën që i përket:

**KËRKUES:
SHEHU.**

******* Shqiptare e Peshëngritjes, përfaqësuar me autorizim nga Av. Sokol**

OBJEKTI: Regjistrimin e vendimit Nr.1, datë 26 Dhjetor 2020 të Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore në regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”. Ligji nr.8192, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet bashkëngjitur saj si dhe praktikën e tërhequr nga Arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Kërkuesi, *** Shqiptare e Peshëngritjes i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë me objektin e sipërcituar.**

Gjykata në seancë gjyqësore konstatoi se pala kërkuese bashkëngjitur kërkesës për regjistrimin e vendimit Nr.1., datë 26 Dhjetor 2020 të Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

Fletë Votimi.

Lista e Votuesve të Asmblesë së Zakonshme Zgjedhore 26 Dhjetor 2020.

Mandate Përfaqësimi.

Procesverbale datë 26.12.2020 të Komisionit të Votimit. (3 copë).

Gjykata vlerëson se në zbatim të nenit 3 të Kodit të Procedurës Civile kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi në format dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Në nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se:

« Kur kërkesë padia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave, pasi të jetë shënuar në kërkesë padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime.

Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesë padia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera. »

Gjykata konstatoi në seancë gjyqësore se kërkesa nuk është shoqëruar me të gjitha aktet e domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe konkretisht:

Kërkohet konfirmimi se kush janë ekipet e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes të federuara për vitin 2020. Sa ekipe janë në total në Federatën Shqiptare të Peshëngritjes dhe sa janë pezulluar në vitin 2020.

Vendimet e zbardhura të marra më datë 26.12.2020 nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes që kërkohen të regjistrohen pranë regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata për plotësimin e të metave i la afat deri në seancën e radhës gjyqësore.

Gjykata në seancën gjyqësore të datës 17.06.2021, konstatoi se pala kërkuese paraqiti si provë:

Vendimin Nr.1, datë 26 Dhjetor 2020, i protokolluar me Nr. 65 Prot., datë 20.05.2021, i nënshkruar nga Elez GJOZA.

Email i Sekretarit të Përgjithshëm Edlir MEMAJ, drejtuar klubeve më datë 13.10.2020, nga i cili rezulton se janë pezulluar për periudhë një vjeçare 5 Ekipe, si Alba 2008, Dinamo, Ismail Bej Vlora, Peqini, Ymer Ferhati Elbasan.

Gjykata çmon se pala kërkuese nuk i plotësoi të metat e kërkesës, pasi vendimi i marrë më datë 26 Dhjetor 2020, nuk mund të paraqitet me datë të mëvonshme Nr. 65 Prot., datë 20.05.2021.

Gjykata po kështu konstaton se kërkesa drejtuar Gjykatës është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm Edlir MEMAJ, ndërkohë që duhet të ishte nënshkruar nga Kryetari i Federatës pasi ai përfaqëson Federatën në marrëdhënie me të tretët.

Gjithashtu nuk ekziston një nprocesverbal i mbajtur në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Federatës, për të dokumentuar ekipet që morën pjesë dhe formimin e Komisionit të Votimit.

Nga sa më sipër gjykata konkludon se të metat e kërkesës janë thelbësore, dhe nuk mund të riparohen më vonë në kushtet kur nuk është mbajtur procesverbal për zhvillimin e mbledhjes sipas rregullave të përcaktuara në ligjet nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe nr. 8192, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Po kështu vendimi që kërkohet të regjistrohet nuk është zbardhur në momentin e zhvillimit të mbledhjes dhe nuk është nënshkruar nga Kryetari i mëparshëm apo dhe nga anëtarët e Këshillit Drejtues të mëparshëm, si dhe kërkesa nuk është nënshkruar nga Kryetari por nga Sekretari i Përgjithshëm.

Nga sa më sipër gjykata konkludon në kthimin e kërkesës së bashku me aktet e çështjes civile Nr.192 Regj.Them, datë regjistrimi 13.01.2021 kërkuësit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 127 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

Kthimin e kërkesës së bashku me aktet e çështjes civile Nr.192 Regj Them, datë regjistrimi 08.10.2020 kërkuësit *** Shqiptare e Peshëngritjes.**

Kërkesa quhet sikur nuk është paraqitur.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuësit.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve duke

nisur ky afat nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, më datë 17.06.2021.

SEKRETARE

Ejvisa MOLLA

GJYQTARE

Anila KARANXHA

